



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 10, Datë 07. 01. 2019

Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për prokurorë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2017 - 2018

Në përputhje me nenin 148/ç të Kushtetutës, nenin 35/1/c të Ligjit nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe nenin 271 të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

Neni 1

Të fillojë procedurën e verifikimit të pasurisë dhe të figurës së kandidatëve për prokurorë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2017 - 2018.

Neni 2

Ngarkohet administrata e Këshillit që, jo më vonë se 2 ditë pune nga dita e miratimit të këtij Vendimi, të hartojë dhe të përgatisë për firmën e Kryetarit të Këshillit, shkresat që iu drejtohen institucioneve të parashikuara në nenin 32/2 të Ligjit "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për prokurorë.

Neni 3

Institucionet e ngarkuara nga ligji me detyrën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për prokurorë janë të ftuara të kryejnë verifikimet e nevojshme jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e marrjes së shkresave të përmendura në nenin 2 të këtij Vendimi.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

